

Fleta e të dhënave të produktit
 Botimi 08/07/2014
 Nr. i identifikimit: 022603010039001000
 Kodi: 10.01.040



ETAG 002-1999

10

0757

Sikasil[®] SG-20

Ngjitës strukturor prej silikoni me rezistencë të lartë

Të dhëna teknike të produktit

Baza kimike	Silikon prej 1 përbërësi
Ngjyra (CQP ¹ 001-1)	E zezë, gri, e bardhë
Mekanizmi i pjekurimit	Pjekurohet me lagështinë
Lloji i pjekurimit	Neutral
Dendësia (e materialit të papjekuruar) (CQP 006-4)	~ 1.37 kg/l
Varja (CQP 061-4 / ISO 7390)	~ 1 mm
Temperatura e aplikimit	5 - 40°C (40 - 105°F)
Koha e krijimit të epidermës ² (CQP 019-2)	~ 15 min
Koha e pjekurimit të sigurt sipërfaqësor ² (CQP 019-1)	~ 180 min
Shpejtësia e pjekurimit (CQP 049-1)	Shih diagramën 1
Fortësia Shore A (CQP 023-1 / ISO 868)	~ 39
Rezistenca ndaj forcës tërheqëse (CQP 036-1 / ISO 37)	~ 2.2 N/mm ²
Zgjatimi deri në thyerje (CQP 036-1 / ISO 37)	~ 450%
Rezistenca ndaj përhapjes së grisjes (CQP 045-1 / ISO 34)	~ 7 N/mm
Moduli i elasticitetit në 100% zgjatim (CQP 036-1 / ISO 37)	~ 0.9 N/mm ²
Aftësia për të lëvizur (ASTM C 719)	± 25%
Rezistenca termike (CQP 513-1)	~ 180°C (355°F)
Afatgjatë	4 orë
Afatshkurtër	1 orë
Temperatura e funksionimit	-40 deri në 150°C (-40 deri në 300°F)
Jetëgjatësia (magazinin nën 25°C) (CQP 016-1)	9 muaj

¹⁾ CQP = Corporate Quality Procedure

²⁾ 23°C (73°F) / 50% L.R.

Përshkrimi

Sikasil[®] SG-20 është ngjitës silikoni pjekurimi neutral, i cili kombinon rezistencën mekanike me elasticitetin e lartë. Ka ngjitje të shkëlqyer mbi një shumëllojshmëri të madhe nënshtresash.

Sikasil[®] SG-20 prodhohet në përputhje me sistemin garantimit të cilësisë ISO 9001 / 14001 dhe me programin brenda kompanisë responsible care.

Avantazhet e produktit

- Silikonë strukturore-vulosëse prej një përbërësi për montime strukturore të konstruksioneve prej qelqi të kategorisë I-IV në përputhje me ETAG 002. DoP 01 26 03 01 003 9 001000 1024, i certifikuar nga organizata e kontrollit të prodhimit në fabrikë, 0757 dhe mbart shenjën CE.
 - Përbush kërkesat e ASTM C 1184, EN 13022

- Klasifikimi ndaj zjarrit (EN 11925-2/DIN 4102-B1)
- Rezistencë e shkëlqyer ndaj rrezatimit UV dhe ndikimeve klimaterike
- Ngjitet shkëlqyeshëm mbi qelqin, metalin, metalet e lyera, plastikën dhe drurin.



Fushat e përdorimit

Sikasil® SG-20 mund të përdoret për ngjitje strukturore të glazurës, ngjitje të paneleve diellore, por edhe në shumë aplikime të tjera industriale.

Ky produkt duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë. Duhet të kryhen eksperimente në kushte reale dhe me nënshtresat reale në mënyrë që të sigurohet ngjitja dhe kompatibiliteti i materialit.

Mekanizmi i pjekurimit

Sikasil® SG-20 pjekurohet me lagështinë atmosferike. Kështu, reaksioni fillon nga sipërfaqja e ngjitësit (që vjen në kontakt me lagështinë atmosferike) dhe vijon në brendësinë e tij. Shpejtësia e pjekurimit varet nga lagështia relative dhe temperatura (shihni diagramën më poshtë). Ngrohja e produktit në temperatura mbi 50°C, për përsheptimin e pjekurimit nëpërmjet vullkanizimit, nuk rekomandohet, pasi mund të ndikojë në krijimin e fluskave brenda masës së materialit. Në temperatura të ulëta përmbajtja e lagështisë së ajrit është në përgjithësi më e ulët dhe reaksioni i pjekurimit vazhdon më ngadalë (shih diagramën).

Kompatibiliteti i produktit me guarnicionet, kordonat e mbushjes së bashkimit, vendfiksueset për hapësirën, midis dhe materialeve të tjera të tilla duhet që të testohet përpara aplikimit.




Diagrama 1: Shpejtësia e pjekurimit të Sikasil® SG-20

Shënime mbi aplikimin/ Kufizime

Shumica e Sikasil® WS, FS, SG, IG, WT, AS dhe silikonëve të tjera mekanike që prodhohen nga Sika kanë kompatibilitet me tyre dhe me vulosësit SikaGlaze® IG. Për udhëzime konkrete për sa i përket kompatibilitetit të produkteve të ndryshme Sikasil® dhe SikaGlaze®, kontaktoni me departamentin teknik të Sika-s. Për të përdorur çfarëdolloj tjetër vulosësi bashkë me produktet Sikasil® duhet të jepet miratimi nga Sika. Në raste kur dy apo më shumë vulosës që përdoren bashkë, krijojnë reaksion, do të duhet që i pari të jetë pjekuruar plotësisht përpara aplikimit të dytë. Produktet Sikasil® SG, IG dhe WT duhet të përdoren vetëm nga aplikues profesionistë në ngjitjen dhe vulosjen e glazurës dhe pas kontrollit të kujdesshëm dhe miratimit me shkrim nga departamenti teknik i Sika-s.



Sika Albania SHPK
Rruga Ibrahim Rugova,
Sky Tower, Building no. 5,
9th floor, Office 91,
Tirana, Albania.
Tel.: +355 4 454 0070
Email: info@al.sika.com
alb.sika.com

Informacionet e mësipërme jepen vetëm si udhëzime të përgjithshme. Informacione mbi aplikime konkrete jepen sipas kërkesës.

Metoda e aplikimit

Përgatitja e sipërfaqes

Sipërfaqet duhet të jenë të pastra, të thata dhe pa gjurmë grasoje, vajrash dhe pluhuri. Këshilla për aplikime specifike dhe përgatitjeje sipërfaqesh jepen nga departamenti teknik i Sika-s.

Aplikimi

Pas përgatitjes së duhur të nënshtresave dhe dimensionimit të bashkimeve, aplikojmë Sikasil® SG-20. Dimensionimi i bashkimeve duhet të jetë i saktë që në fillim që të jenë të forta edhe pas kalimit të kohës së punueshmërisë. Baza për llogaritjen e dimensionimit të bashkimeve janë vlerat teknike të ngjitesit, materialet e ndërtimit-ngjitjes, ekspozimi i tyre ndaj kushteve të mjedisit, mënyra e montimit-ndërtimit ashtu si dhe ngarkesat e ngarkuara. Materiali nuk duhet të aplikohet në trashësi mbi 15 mm.

Për më shumë informacione, kontaktoni me departamentin teknik të Sika-s.

Përpunimi mekanik dhe përfundimi

Përpunimi mekanik dhe përfundimi duhet të bëhen brenda kohës së krijimit të epidermës të vulosësit.

Kur përpunojmë Sikasil® SG-20 e freskët duhet të ushtrujmë presion mbi produktin brenda bashkimit që të kemi mbulim të plotë të tij dhe lagje të mire të sipërfaqeve që do të ngjiten. Nuk duhet të përdoren produkte përpunimi mekanik.

Largimi i mbetjeve

Materiali Sikasil® SG-20 i papjekuruar mund të largohet nga mjetet dhe pajisja e aplikimit me Sika® Remover-208 ose me një tretës tjetër të përshtatshëm. Materiali i pjekuruar mund të largohet vetëm mekanikisht. Duart dhe lëkura e ekspozuar duhet të lahen menjëherë duke përdorur pecetat Sika® Handclean ose me një pastrues të përshtatshëm industrial për duart dhe ujë. Mos përdorni tretës!

Lyerja

Sikasil® SG-20 është ngjites elastik dhe nuk mund të lyhet.

Informacione të tjera

Disponohen kopje të dokumenteve të mëposhtme sipas kërkesës:

- Fleta e të dhënave të sigurisë
- Udhëzime të përgjithshme
- “Ngjitje strukturore të glazurës me ngjitesit Sikasil®”

Informacione mbi ambalazhimin

Fishek	300 ml
Tubetë	600 ml

Baza e vlerave të matshme

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

Informacione mbi

shëndetin dhe sigurinë

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit të sigurt, maganizimit dhe asgjësimit të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen botimit më të fundit të fletës me të dhënat e sigurisë (Safety Data Sheet, SDS), e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike, etj. rreth sigurisë gjatë përdorimit të produktit.

Shënime ligjore

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të SIKA-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e SIKA-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj formë tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë

përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. SIKA ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositet pranohen sipas të gjitha kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit.



Sika Albania SHPK
Rruga Ibrahim Rugova,
Sky Tower, Building no. 5,
9th floor, Office 91,
Tirana, Albania.
Tel.: +355 4 454 0070
Email: info@al.sika.com
alb.sika.com